



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-CA-2023-02

**Vendosi:** **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**  
Gjykatëse Mishelë Pikar  
Gjykatës Kai Ambos  
Gjykatëse Nina Jorgensen

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 10 shtator 2024

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim për Lëshimin e një Vendimi të Ri Dënimi për Salih Mustafën**

---

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**

Kimberli P. Uest

**Mbrojtjes së Salih Mustafës:**

Julius von Bone

**Mbrojtëses së Viktimave:**

Ani Pues

**PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT** i Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht, “Paneli i Gjykatës së Apelit”, “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”),<sup>1</sup> duke vepruar në bazë të nenit 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullave 172 dhe 194(1)(b) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”), në vijim të Vendimit mbi Kërkesën e Salih Mustafës për Mbrojtje të Ligjshmërisë (“Vendimi i Gjykatës Supreme”) të lëshuar më 29 korrik 2024 nga Paneli i Dhomës së Gjykatës Supreme (“Paneli i Gjykatës Supreme”),<sup>2</sup> lëshon këtë vendim të ri dënimi për z. Salih Mustafa (“Mustafa”).

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 16 dhjetor 2022, Trupi Gjykues I lëshoi aktgjykimin (“Aktgjykimi”) me të cilin e shpalli Mustafën, komandant i BIA-s,<sup>3</sup> fajtor: (i) për kryerjen, si pjesë e ndërmarrjes kriminale të përbashkët I (“NKP I”),<sup>4</sup> të ndalimit arbitrar si krim lufte kundër së paku gjashtë personave, afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999, në kompleksin e ndalimit në Zllash, Kosovë (“kompleksi i ndalimit në Zllash”) (Pika 1); (ii) për kryerjen e drejtpërdrejtë dhe në kuadër të NKP I, të torturës si krim lufte kundër së paku gjashtë personave, gjatë të njëjtës periudhe kohore dhe në të njëjtin vend (Pika 3); dhe (iii) për kryerjen, si pjesë e NKP I, të vrasjes së paligjshme si krim lufte, kundër një personi, afërsisht midis 19 prillit 1999 dhe fundit të prillit 1999, në

---

<sup>1</sup> F00044, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 31 korrik 2024.

<sup>2</sup> KSC-SC-2024-02, F00018, Vendim mbi Kërkesën e Salih Mustafës për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 29 korrik 2024 (“Vendimi i Gjykatës Supreme”).

<sup>3</sup> “BIA” është emërtimi i njësitit gueril BIA, një njësit brenda zonës operative të Llapit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

<sup>4</sup> NKP I shënon formën bazë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët (“NKP”).

kompleksin e ndalimit në Zllash (Pika 4).<sup>5</sup> Trupi Gjykes caktoi për Mustafën dënimin e njëzuar me 26 vjet burgim, në të cilin u llogarit koha e kaluar në paraburgim.<sup>6</sup>

2. Më 2 shkurt 2023, Mustafa dorëzoi njoftimin për apel kundër Aktgjykimit,<sup>7</sup> dhe më 24 prill 2023, dosjen e tij të apelit,<sup>8</sup> në të cilën paraqiti nëntë pika apeli, dhe kërkoi, ndër të tjera, që Paneli i Gjykatës së Apelit të prapësonte të gjitha verdiktet e fajësisë për veprat penale, ose në rast se Paneli i Gjykatës së Apelit linte në fuqi verdiktet e fajësisë, të ulte dënimin e dhënë.<sup>9</sup> Më 5 qershor 2023, Mbrojtësja e Viktimave dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzuan dosjet e përgjigjeve të tyre,<sup>10</sup> dhe më 16 qershor 2023, Mustafa dorëzoi kundërpërgjigjen e tij.<sup>11</sup>

---

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-05, F00494/RED3/COR, Version i Redaktuar më Tej i Versionit të Korrigjuar të Versionit të Redaktuar Publik të Aktgjykimit, 8 qershor 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 16 dhjetor 2022) (“Aktgjykimi”), para. 758-760, 831. Trupi Gjykes gjykoi se akuza për krimin e luftës të trajtimit mizor “mbulohet plotësisht” nga akuza e krimin të luftës të torturës dhe, rrjedhimisht, e shpalli Mustafën të pafajshëm për krimin e luftës të trajtimit mizor (Pika 2). Shih Aktgjykimin, para.667, 831.

<sup>6</sup> Aktgjykimi, paras 829-831.

<sup>7</sup> F00006/RED2, Version i Redaktuar Publik i Njoftimit të Apelit të Mbrojtjes sipas Rregullës 176 (të Rregullores së Procedurës dhe të Provave) kundër Aktgjykimit të Trupit Gjykes I të 16 dhjetorit 2022, 13 shkurt 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 2 shkurt 2023) (Njoftimi për Apel”).

<sup>8</sup> F00021/COR/RED3, Version i Dytë Publik i Redaktuar më Tej i Versionit të Korrigjuar të Dosjes së Apelit të Mbrojtjes sipas Rregullës 179(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”), 15 shtator 2023 (versioni konfidencial i pakorrigjuar u dorëzua më 24 prill 2023, versioni konfidencial i korrigjuar u dorëzua më 2 maj 2023) (“Dosja e Apelit”).

<sup>9</sup> Njoftimi për Apel, para. 2; Dosja e Apelit, para. 3, 446. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 323, 341, 367, 378, 390, 400, 438.

<sup>10</sup> F00026/RED3, Version i Dytë Publik i Redaktuar më Tej i Përgjigjes së Mbrojtëses së Viktimave ndaj Dosjes së Apelit të Mbrojtjes F00021, 15 shtator 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 5 qershor 2023); F00027/RED/COR, Version i Korrigjuar i Versionit të Redaktuar Publik të Dosjes së Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Apelit të Mbrojtjes, KSC-CA-2023-02/F00027/RED, 23 qershor 2023 (versioni i pakorrigjuar konfidencial u dorëzua më 5 qershor 2023, versioni i pakorrigjuar publik u dorëzua më 21 qershor 2023) (“Dosja e Përgjigjes së ZPS-së”).

<sup>11</sup> F00028/RED, Version i Redaktuar Publik i Dosjes së Kundërpërgjigjes së Mbrojtjes ndaj Dosjes së Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Apelin e Mbrojtjes dhe Përgjigjen e Mbrojtëses së Viktimave ndaj Dosjes së Apelit të Mbrojtjes F00021 sipas Rregullës 179(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”), 3 korrik 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 16 qershor 2023).

3. Më 6 prill 2023, Trupi Gjykses lëshoi një urdhër kundër Mustafës, me të cilin u akordoi dëmshpërblime tetë viktimave pjesëmarrëse në proces ("Urdhri për Zhdëmtim").<sup>12</sup> Mustafa nuk e apeloj Urdhrin për Zhdëmtim.

4. Më 14 dhjetor 2023, Paneli i Gjykatës së Apelit shqiptoi Aktgjykimin e Apelit me të cilin la në fuqi verdiktet e fajësisë së Mustafës për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme, por miratoi, pjesërisht, apelin e tij kundër dënimit.<sup>13</sup> Për këtë qëllim, Paneli i Gjykatës së Apelit i uli dënimet për secilën vepër penale që Trupi Gjykses i kishte dhënë Mustafës dhe shqiptoi dënimet në vijim: (i) tetë vjet burgim (më parë 10 vjet) për Pikën 1 të Aktakuzës (për krimin e luftës të ndalimit arbitrar të kryer kundër së paku gjashtë personave); (ii) 20 vjet burgim ( më parë 22 vjet) për Pikën 3 të Aktakuzës (për krimin e luftës të torturës, të kryer kundër së paku gjashtë personave); dhe (iii) 22 vjet burgim (më parë 25 vjet) për Pikën 4 të Aktakuzës (për krimin e luftës të vrasjes së paligjshme, të kryer kundër një personi).<sup>14</sup> Në vijim, Paneli i Apelit uli dënimin e njësuar të Mustafës në 22 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim, dhe konsideruar se ky dënim pasqyronte tërësinë e veprimtarisë kriminale të Mustafës në këtë çështje.<sup>15</sup>

5. Më 14 mars 2024, Mustafa dorëzoi një kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ("Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë"), në Arsyet 1 dhe 3 të së cilës, argumentoi se pavarësisht nga ulja e dënimit të tij nga Paneli i Apelit, vlerësimi i Panelit – përfshirë në lidhje me parimin *lex mitior* dhe shkallëzimet e zbatueshme të dënimit – shkelte nenin 44(2) të Ligjit dhe nenet 22, 33(2) dhe (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

---

<sup>12</sup> KSC-BC-2020-05, F00517/RED/COR, KSC-BC-2020-05, F00517/RED/COR, Version i Korrigjuar i Versionit të Redaktuar Publik të Urdhrit për Zhdëmtim kundër Salih Mustafës, 14 prill 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 6 prill 2023) ("Urdhri për Zhdëmtim").

<sup>13</sup> F00038/RED, Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit të Apelit, 14 dhjetor 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 14 dhjetor 2023) ("Aktgjykimi i Apelit"), para. 484.

<sup>14</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 480, 484.

<sup>15</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 480, 484.

(“Kushtetuta”).<sup>16</sup> Mustafa kërkoi që Paneli i Gjykatës Supreme t’i miratonte këto arsye dhe, ose të modifikonte Aktgjykimin e Apelit, ose ta anulonte atë dhe në bazë të rregullës 194(1)(a) dhe (b), t’ia kthente çështjen panelit kompetent për vendim të ri ose rigjykim.<sup>17</sup>

6. Përkatësisht më 12 dhe 15 prill 2024, Mbrojtësja e Viktimave dhe ZPS-ja dorëzuan përgjigjet e tyre ndaj Kërkesës për Mbrojtje të Ligjshmërisë.<sup>18</sup> Më 3 maj 2024, Mustafa dorëzoi kundërpërgjigjet e tij.<sup>19</sup>

7. Më 29 korrik 2024, Paneli i Gjykatës Supreme lëshoi Vendimin e Gjykatës Supreme, në të cilin, ndër të tjera: (i) miratoi Arsyet 1 dhe 3 të Kërkesës për Mbrojtje të Ligjshmërisë për arsytet e përshkruara më poshtë; (ii) anuloi Aktgjykimin e Apelit në lidhje me dënimin e Mustafës në bazë të rregullës 194(1)(b) të Rregullores; dhe (iii) ia ktheu Aktgjykimin e Apelit Panelit të Apelit për të marrë një vendim të ri.<sup>20</sup>

---

<sup>16</sup> KSC-SC-2024-02, F00011, Kërkesë e Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë me Shtojcat Konfidenciale 1 dhe 2 në bazë të Nenit 48 (6) deri (8) të Ligjit dhe Rregullës 193 të Rregullores, 14 mars 2024 (“Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë”), para. 23-49, 67-87, 117. Në lidhje me përcaktimin e dënimit, në Arsyen 2, Mustafa gjithashtu kundërshtoi interpretimin që Paneli i Apelit i bëri nenit 44(2) të Ligjit, me pretendimin se Paneli i Apelit e kishte kuptuar gabim shprehjen “marrin parasysht” si shprehje nën të cilën renditeshin “faktorë” e jo ligje që përcaktojnë shkallëzimet përkatëse të dënimeve, të cilat Paneli është *i detyruar* t’i marrë parasysht. Shih, në veçanti, Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 52-54. Gjithashtu, në Arsyen 4, Mustafa kundërshtoi konstatimet e Panelit të Apelit në lidhje me vrasjen e paligjshme si krim lufte, dhe në Arsyen 5, ngriti kundërshtimin në lidhje me kohën që kishte marrë për kthimin i Aktgjykimit të Apelit. Shih Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 88-116.

<sup>17</sup> Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para 66, 87, 117.

<sup>18</sup> KSC-SC-2024-02, F00013, Përgjigje e Mbrojtëses së Viktimave ndaj Kërkesës për Mbrojtjen e Ligjshmërisë, 12 prill 2024 (“Përgjigja e Mbrojtëses së Viktimave ndaj Kërkesës për Mbrojtjen e Ligjshmërisë”); KSC-SC-2024-02, F00014, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës për Mbrojtjen e Ligjshmërisë, 15 prill 2024 (“Përgjigja e ZPS-së ndaj Kërkesës për Mbrojtjen e Ligjshmërisë”).

<sup>19</sup> KSC-SC-2024-02, F00016, Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 3 maj 2024; KSC-SC-2024-02, F00017, Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes së Mbrojtëses së Viktimave në lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 3 maj 2024.

<sup>20</sup> Vendimi i Gjykatës Supreme, para. 74-112. Shih më poshtë, para. 9-15. Paneli i Gjykatës Supreme rrëzoi gjithashtu Arsyet 2 dhe 5 dhe rrëzoi me procedurë të shkurtuar Arsyen 4. Shih Vendimin e Gjykatës Supreme, para. 44, 57, 63, 112. Gjykata Supreme gjithashtu urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Mustafës ndërkohë që shqyrtohej marrja e një vendimi të ri të dënimit të tij nga Paneli i Gjykatës së Apelit. Shih Vendimin e Gjykatës Supreme, para. 112.

## II. DISKUTIM

8. Para se të kalojë te vendimi i ri i dënimit për Mustafën, Paneli i Apelit fillimisht do të ravijëzojë parimet udhëzuese të përcaktuara nga Paneli i Gjykatës Supreme.

### A. UDHËZIMET E PANELIT TË GJYKATËS SUPREME

9. Paneli i Gjykatës Supreme konfirmoi interpretimin që Paneli i Apelit i bëri nenit 44(2) të Ligjit se elementet e renditura në këtë dispozitë, konkretisht shkallëzimet e dënimeve sipas legjislacionit shtetëror, janë “faktorë” të cilët paneli i shkallës më të ulët “i merr parasysh” dhe jo shkallëzime dënimesh të cilat panelet e shkallëve më të ulëta duhet t’i zbatojnë.<sup>21</sup>

10. Sidoqoftë, Paneli i Gjykatës Supreme konstatoi se Paneli i Apelit gaboi dhe “shkeli të drejtën penale” brenda kuptimit të nenit 48(7) të Ligjit në tre aspekte.<sup>22</sup>

11. Së pari, Paneli i Gjykatës Supreme konstatoi se Paneli i Apelit gaboi në përfundimin se Dhomat e Specializuara nuk janë të detyruara të marrin parasysh ligjet e ndryshme shtetërore për krime të luftës për të përmbushur parimin *lex mitior* sipas Kushtetutës.<sup>23</sup> Përkundrazi, Paneli i Gjykatës Supreme u shpreh se Dhomat e Specializuara janë të detyruara të marrin parasysh atë shkallëzim dënimi sipas legjislacionit të Kosovës që është më i butë, në përputhje me parimin *lex mitior*, dhe ta marrin parasysh atë kur përcaktojnë dënimin me burgim.<sup>24</sup>

12. Së dyti, Paneli i Gjykatës Supreme konstatoi se Paneli i Apelit gaboi kur “nuk përcaktoi në fillim shkallëzimin përfundimtar të dënimit” [...] përpara se të përcaktonte dënimin”.<sup>25</sup> Në lidhje me këtë, Paneli i Gjykatës Supreme dha sqarime për

---

<sup>21</sup> Vendimi i Gjykatës Supreme, para. 62, 106; Aktgjykimi i Apelit, para. 466.

<sup>22</sup> Vendimi i Gjykatës Supreme, para. 75, 108.

<sup>23</sup> Vendimi i Gjykatës Supreme, para. 86-87 dhe arsyetimi që përmban, 108. Shih gjithashtu, Aktgjykimin e Apelit, para. 467-469.

<sup>24</sup> Vendimi i Gjykatës Supreme, para. 87 dhe arsyetimi që përmban, 88.

<sup>25</sup> Vendimi i Gjykatës Supreme, para. 92. Shih gjithashtu Vendimin e Gjykatës Supreme, para. 108.

dispozitat ligjore në fuqi dhe konstatoi se Kodi Penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë i vitit 1976 (“Kodi Penal i RSFJ-së i vitit 1976”) dhe të gjitha ndryshimet që i ishin bërë atij, janë të pazbatueshëm kur shqyrtohen shkallëzimet e dënimeve që duhet të merren parasysh, në përputhje me nenin 44(2)(a) and (b) të Ligjit.<sup>26</sup> Sa i përket legjislacionit të Kosovës që zbatohet për përcaktimin e shkallëzimit të dënimit më të butë, Paneli i Gjykatës Supreme shqyrtoi kodet penale përkatëse të Kosovës të cilat gjykoi se përkonin “më së afërmi” me krimet e luftës sipas të drejtës ndërkombëtare zakonore, siç përcaktohet në nenin 14(1)(c) të Ligjit,<sup>27</sup> dhe përfundimisht arriti në përfundimin se “shkallëzimi i dënimit më të butë që duhet të merret parasysh në rastin e z. Mustafa në përputhje me nenin 44(2)(b) të Ligjit dhe nenin 146(1) së bashku me nenet 42(1) të [Kodit Penal të Republikës së Kosovës të vitit 2019], është ai me burgim nga pesë deri në 25 vjet.”<sup>28</sup>

13. Së treti, Paneli i Gjykatës Supreme konstatoi se Paneli i Apelit nuk arsyetoi si duhet se si arriti në uljen me katër vjet të dënimit të Mustafës.<sup>29</sup>

14. Pas përcaktimit të shkallëzimit përkatës të dënimit, Paneli i Gjykatës Supreme u pajtua me konstatimin e Panelit të Apelit se kishte një mospërputhje midis dënimeve të Mustafës dhe atyre të analizuar nga jurisprudenca ndërkombëtare dhe ajo e Kosovës.<sup>30</sup> Në këtë aspekt, Paneli i Gjykatës Supreme vuri në dukje se në çështjet gjyqësore që kishte analizuar e që ishin të ngjashme me atë të Mustafës sa i përket

---

<sup>26</sup> Vendimi i Gjykatës Supreme, para. 97 dhe arsyetimi që përmban. Shih gjithashtu Vendimin e Gjykatës Supreme, poshtëshënimin 159. Për dallim, Paneli i Apelit pranoi se, në përputhje me nenin 44(2)(a) të Ligjit, Trupi Gjykues iu referua saktësisht neneve 38 dhe 142 të Kodit Penal të RSFJ-së të vitit 1976 si dispozita ligjore përkatëse të zbatueshme. Shih Aktgjykimin e Apelit, para. 473.

<sup>27</sup> Vendimi i Gjykatës Supreme, para. 99-102.

<sup>28</sup> Vendimi i Gjykatës Supreme, para. 102. Për dallim, Paneli i Apelit konstatoi se (i) me miratimin e Rregullores 1999/24 të UNMIK-ut që anuloi dënimin me vdekje, shkallëzimi i dënimit sipas Kodit Penal të RSFJ-së të vitit 1976 u bë nga pesë deri në 15 vjet burgim; dhe (ii) kodet penale të Kosovës të miratuara më vonë parashikonin dënime maksimale më të rënda. Shih Aktgjykimin e Apelit, para. 473-474.

<sup>29</sup> Vendimi i Gjykatës Supreme, para. 75, 103, 108. Në lidhje me këtë, Paneli i Gjykatës Supreme gjykoi se “për shkak se nuk u përcaktua shkallëzimi i dënimit [nga Paneli i Apelit], është e pamundur të dihet dënimi maksimal që [Paneli i Apelit] pati parasysh”. Shih Vendimin e Gjykatës Supreme, para. 103.

<sup>30</sup> Vendimi i Gjykatës Supreme, para. 104. Shih gjithashtu Aktgjykimin e Apelit, para. 478-479.

kontekstit, krimeve bazë për të cilat ishin ngritur akuzat dhe numrit të viktimave, ishin dhënë dënime me shumë më pak se 22 vjet burgim.<sup>31</sup> Paneli i Gjykatës Supreme gjithashtu pati të njëjtin mendim me Panelin e Apelit se dënimet për secilën veprë penale të dhëna nga Trupi Gjykses, veçanërisht për torturën dhe vrasjen e paligjshme, “tejkaluuan kufijtë e diskrecionit të Trupit Gjykses, duke i dhënë z. Mustafa dënime jashtë proporcionit të arsyeshëm krahasuar me një varg dënimesh të dhëna në rrethana të ngjashme për vepra penale të ngjashme”.<sup>32</sup>

15. Pavarësisht se Paneli i Gjykatës Supreme pranoi se dënimi me 22 vjet burgim i dhënë nga Paneli i Apelit është brenda shkallëzimit të dënimit që Paneli i Gjykatës Supreme ka konstatuar, diskrecionit të gjerë në dhënien e dënimeve që kanë panelet e shkallës më të ulët dhe natyrës jodetyruese të shkallëzimeve të dënimeve sipas legjislacionit shtetëror përkatës,<sup>33</sup> Paneli i Gjykatës Supreme gjykoi se Paneli i Apelit mund të kishte arritur në një përcaktim të ndryshëm të dënimit të duhur për z. Mustafa, nëse do të kishte përcaktuar saktë shkallëzimin e dënimit prej pesë deri në 25 vjet burgim si shkallëzim që duhet të merret parasysh.<sup>34</sup> Duke marrë parasysh se Paneli i Apelit ishte në pozitë më të mirë për të përcaktuar dënimin e duhur për Mustafën,<sup>35</sup> Paneli i Gjykatës Supreme ia ktheu çështjen Panelit të Apelit për një vendim të ri në lidhje me gabimet e evidentuara më sipër, me udhëzimin që Paneli i Apelit të orientohet nga:

(i) rregulla 163 e Rregullores; (ii) shkallëzimi i dënimit prej pesë deri në 25 vjet burgim i konstatuar nga Paneli [i Gjykatës Supreme] në

---

<sup>31</sup> Vendimi i Gjykatës Supreme, para. 105.

<sup>32</sup> Vendimi i Gjykatës Supreme, para. 105, që citon paragrafin 479 të Aktgjykimit të Apelit, ku Paneli i Apelit, ndonëse plotësisht i vetëdijshëm për diskrecionin e gjerë të Trupit Gjykses në dhënien e dënimit, arriti në përfundimin se “mospërputhja ndërmjet dënimeve të z. Mustafa dhe dënimeve që analizoi Paneli, tregon se Trupi Gjykses i tejkaloj kufijtë e diskrecionit të vet duke i dhënë z. Mustafa dënime jashtë proporcionit të arsyeshëm krahasuar me një varg dënimesh të dhëna në rrethana të ngjashme për vepra penale të ngjashme, me çka kreu një gabim të dallueshëm në përcaktimin e dënimit”.

<sup>33</sup> Vendimi i Gjykatës Supreme, para. 106.

<sup>34</sup> Vendimi i Gjykatës Supreme, para. 107.

<sup>35</sup> Vendimi i Gjykatës Supreme, para. 110.



çështjen e z. Mustafa; (iii) faktorët e përcaktuar nga Paneli i Apelit për dënimin; (iv) jurisprudenca e analizuar nga Paneli i Apelit dhe Paneli [i Gjykatës Supreme]; dhe (v) rrethanat konkrete të çështjes së z. Mustafa.<sup>36</sup>

## B. ANALIZA E PANELIT TË APELIT

16. Paneli i Apelit tani do të vijojë me vlerësimin e ndikimit, nëse ka, të gabimeve të evidentuara më lart në dënimin e Mustafës, pas udhëzimeve të dhëna nga Paneli i Gjykatës Supreme. Në këtë aspekt, Paneli i Apelit, ka informacion edhe nga parashtrimet e mëhershme të palëve dhe Mbrojtëses së Viktimave në këtë procedurë të përcaktimit të dënimit.<sup>37</sup>

---

<sup>36</sup> Vendimi i Gjykatës Supreme, para. 109-112.

<sup>37</sup> Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 23-49, 67-87; Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës për Mbrojtjen e Ligjshmërisë, para. 11-18, 23-27, Përgjigjja e Mbrojtëses së Viktimave ndaj Kërkesës për Mbrojtjen e Ligjshmërisë, para. 4-12; Dosja e Apelit, para. 401-445; Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 195-238; KSC-BC-2020-05, Transkripti, 15 shtator 2022, f. 4792-4800; KSC-BC-2020-05, F00505/A01, Version i Redaktuar Publik i Shtojcës 1 të Versionit të Korrigjuar të Dosjes Gjyqësore Përfundimtare të Prokurorisë në Përputhje me Rregullën 134(b) me Shtojcën 1 Konfidenciale dhe Shtojcën 2 Publike, Parashtrimi i Protokolluar F00459/COR/A01, i datës 22 Korrik 2022, 31 janar 2023 (KSC-BC-2020-05, F00459/COR/A01, Shtojca 1 e Versionit të Korrigjuar të Dosjes Gjyqësore Përfundimtare të Prokurorisë sipas Rregullës 134(b), 22 korrik 2022 (konfidenciale) (versioni i pakorrigjuar konfidencial u dorëzua më 21 korrik 2022)), para. 344-386; KSC-BC-2020-05, F00456/COR/RED2, Version Publik me më Pak Redaktime i Versionit të Korrigjuar të Deklaratës së Mbrojtëses së Viktimave në lidhje me Pasojat e Krimeve mbi Viktimat Pjesëmarrëse në Proces, 20 mars 2023 (versioni i pakorrigjuar dhe rreptësisht konfidencial u dorëzua më 20 korrik 2022), para. 70-79. Shih gjithashtu CRSPD16, Mesazh Elektronik i Panelit të Apelit drejtuar NJAGJ-së në lidhje me Mesazhin Sqarues për Palët dhe Pjesëmarrësit, 7 gusht 2024, ku Paneli i Apelit sqaroi se nuk kishte nevojë për parashtrime të tjera për vendimin e ri të dënimit të Mustafës sipas rregullës 194(1)(b) të Rregullores, për shkak se Paneli i Gjykatës Supreme ia kishte kthyer çështjen konkrete për shqyrtim Panelit të Apelit.

17. Paneli i Apelit rikujton se dispozitat ligjore në lidhje me dënimet janë të përfshira, ndër të tjera, në nenin 33 të Kushtetutës,<sup>38</sup> në nenin 44 të Ligjit<sup>39</sup> dhe në rregullën 163 të Rregullores.<sup>40</sup>

18. Në lidhje me shkallëzimin e zbatueshëm të dënimit, Paneli i Apelit rikujton se në konstatimet e mëhershme të tij në lidhje me dënimin e Mustafës,<sup>41</sup> e kishte konsideruar burgimin e përjetshëm si dënim maksimal me burgim që mund të jepet dhe kishte analizuar jurisprudencën ndërkombëtare dhe atë të Kosovës, si dhe rrethanat konkrete të çështjes së Mustafës nga ky këndvështrim.<sup>42</sup> Duke pasur parasysh udhëzimet e Panelit të Gjykatës Supreme, Paneli i Apelit në vijim do të marrë parasysh dhe do të orientohet nga shkallëzimi i dënimit prej pesë deri në 25 vjet burgim, i evidentuar nga Paneli i Gjykatës Supreme.<sup>43</sup> Duke mbajtur parasysh këtë shkallëzim dënimi, Paneli i Apelit do të vlerësojë faktorët e mbetur të përcaktuar nga Paneli i Gjykatës Supreme<sup>44</sup> dhe do të përcaktojë dënimin e ri të Mustafës në përputhje me to.

---

<sup>38</sup> Në nenin 33 të Kushtetutës përcaktohen parimet e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit në çështjet penale. Shih Vendimin e Gjykatës Supreme, para. 82, 88.

<sup>39</sup> Në veçanti, në nenin 44(1) të Ligjit përcaktohet se Dhomat e Specializuara mund të shqiptojnë dënim maksimal me burgim të përjetshëm. Në nenin 44(2) të Ligjit specifikohet se, në përcaktimin e dënimit që do të shqiptojë për një krim ndërkombëtar, Dhomat e Specializuara marrin parasysh: “a. shkallëzimin e dënimit për atë krim, të përcaktuar sipas legjislacionit të Kosovës në kohën e kryerjes së krimit; b. çfarëdo shkallëzimi të dënimit më të butë të mëvonshëm për atë krim, të përcaktuar në legjislacionin e Kosovës, [...]”. Shih gjithashtu Vendimin e Gjykatës Supreme, para. 81-82, 87-89, 96-97, 102, 106.

<sup>40</sup> Shih Vendimin e Gjykatës Supreme, para. 110-111(i).

<sup>41</sup> Paneli i Apelit rikujton se dënimin e njëzuar me 26 vjet burgim të dhënë nga Trupi Gjykses, e uli në 22 vjet burgim. Shih Aktgjykimin e Apelit, para. 480, 484.

<sup>42</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 449-450, 478-479. Shih gjithashtu Aktgjykimin e Apelit, para. 469.

<sup>43</sup> Shih më lart, para. 12, 15. Paneli i Apelit sqaron se, në përputhje me udhëzimet e Panelit të Gjykatës Supreme, shkallëzimi i dënimit prej pesë deri në 25 vjet burgim, nuk është i detyrueshëm dhe, në parim, burgimi i përjetshëm mbetet dënimi më i lartë që një panel mund të japë sipas nenit 44(1) të Ligjit. Shih Vendimin e Gjykatës Supreme, para. 106, ku Paneli i Gjykatës Supreme konstatoi se “Paneli është gjithashtu i vetëdijshëm se panelet e shkallëve më të ulëta nuk janë të detyruara të zbatojnë shkallëzimin e përcaktuar të dënimit, por duhet ta marrin parasysh atë.”

<sup>44</sup> Shih Vendimin e Gjykatës Supreme, para. 111.

19. Lidhur me rrethanat konkrete të çështjes Mustafa, Paneli i Apelit sqaron se ato janë: (i) pesha e krimeve dhe pasojat e tyre;<sup>45</sup> (ii) kontributi personal i Mustafës në krime;<sup>46</sup> (iii) rrethanat rënduese dhe lehtësuese;<sup>47</sup> dhe (iv) rrethanat personale të Mustafës.<sup>48</sup> Paneli i Apelit rikujton se ka rrëzuar të gjitha kundërshtimet e Mustafës në lidhje me këto rrethana<sup>49</sup> dhe, rrjedhimisht, miraton vlerësimin e Trupit Gjykses në kuadër të përcaktimit të dënimit të Mustafës.

20. Në përputhje me udhëzimet e Panelit të Gjykatës Supreme,<sup>50</sup> dhe shkallëzimin prej pesë deri në 25 vjet burgim të dënimit të evidentuar nga Paneli i Gjykatës Supreme, Paneli i Apelit ka rianalizuar jurisprudencën ndërkombëtare,<sup>51</sup> përfshirë jurisprudencën e evidentuar nga Paneli i Gjykatës Supreme, në lidhje me krime lufte

---

<sup>45</sup> Paneli i Apelit rikujton se Trupi Gjykses e vlerësoi si të rëndë peshën e krimeve të Mustafës. Në veçanti, Trupi Gjykses mori parasysh: (i) llojin vetvetiu të rëndë të krimeve të luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme dhe rrethanat konkrete të kryerjes së tyre në këtë çështje, përfshirë numrin e viktimave (së paku gjashtë viktima të ndalimit arbitrar dhe torturës dhe një viktimitë të vrasjes së paligjshme); dhe (ii) faktin se këto krime shkaktuan pasoja të rënda dhe afatgjata, fizike dhe psikologjike, te viktimat e ndaluara, dhe psikologjike te anëtarët e familjes së viktimës së vrasjes së paligjshme. Shih Aktgjykimin, para. 796-804, 812.

<sup>46</sup> Paneli i Apelit rikujton konstatimet e Trupit Gjykses, ndër të tjera, në lidhje me: (i) kryerjen drejtpërdrejtë prej Mustafës të krimit të torturës dhe kryerjen e krimit të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme në kuadër të NKP-së, me anëtarë të tjerë të BIA-s; (ii) pozitën eprore dhe rolin qendror të Mustafës në sistemin e ndalimeve të paligjshme dhe torturave në kompleksin e ndalimit në Zllash, si edhe miratimin dhe mbështetjen në vijimësi prej tij të po këtyre veprimeve në periudhën afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999; dhe (iii) faktin se Mustafa personalisht dhe qëllimisht kreu akte torture ndaj dy të ndaluarve, dhe pa dhe urdhëroi keqtrajtimin e tyre dhe të të ndaluarve të tjerë. Në fund, Trupi Gjykses e vlerësoi synimin dhe shkallën e pjesëmarrjes personale të tij në krime, si shumë të lartë. Shih Aktgjykimin, para. 813-819.

<sup>47</sup> Paneli i Apelit rikujton se Trupi Gjykses konsideroi si rrethana rënduese faktin se krimi i torturës u krye në një mënyrë veçanërisht mizore dhe se viktimat në këtë çështje ishin të cenueshme dhe të pambrojtura. Shih Aktgjykimi, para. 805-811.

<sup>48</sup> Paneli i Apelit rikujton se Trupi Gjykses vlerësoi se rrethanave personale të Mustafës nuk mund t'u jepej ndonjë peshë e konsiderueshme. Shih Aktgjykimin, para. 821-826.

<sup>49</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 457-464.

<sup>50</sup> Vendimi i Gjykatës Supreme, para. 111(iv).

<sup>51</sup> Bazuar në konstatimin e Panelit të Gjykatës Supreme se Kodi Penal i RSFJ-së i vitit 1976 nuk është i zbatueshëm, Paneli i Apelit ka anashkaluar jurisprudencën e Kosovës të cilën fillimisht e kishte marrë parasysh në Aktgjykimin e Apelit. Siç theksoi Paneli i Gjykatës Supreme, çështjet gjyqësore të Kosovës lidhen me dënime për krime të dhëna sipas Kodit Penal të RSFJ-së të vitit 1976. Shih Vendimin e Gjykatës Supreme, poshtëshënimin 159. Shih Vendimin e Gjykatës Supreme, para. 97.

të krahasueshme me ato për të cilat është dënuar Mustafa.<sup>52</sup> Në kryerjen e kësaj analize, Paneli i Apelit ka marrë parasysh faktorët që kishte evidentuar në Aktgjykimin e Apelit, të konfirmuar nga Paneli i Gjykatës Supreme, konkretisht: (i) formën e përgjegjesisë penale; (ii) peshën e krimit, përfshirë numrin e viktimave, ndikimin e krimit mbi viktimat, fajësinë individuale të të akuzuarit dhe tregues të tjerë të peshës së veprës penale në rrethanat e kësaj çështjeje gjyqësore; (iii) faktorët e ndryshëm rëndues dhe lehtësues; (iv) nëse trupi gjykues përcaktoi si dënime individuale, ashtu edhe një dënim të njësuar, apo vetëm një dënim të njësuar; dhe (v) krimet e tjera, nëse kishte, për të cilat ishte dënuar edhe ndonjë i akuzuar tjetër.<sup>53</sup> Paneli i Apelit gjithashtu ka mbajtur parasysh se gjykatat ndërkombëtare nuk janë të

---

<sup>52</sup> Aktgjykimi i Apelit, poshtëshënimi 1292 dhe referencat e cituara në të; Vendimi i Gjykatës Supreme, poshtëshënimi 161. Shih gjithashtu Vendimin e Gjykatës Supreme, para. 104-105, 111. Në veçanti, Paneli i Apelit mori parasysh çështjet gjyqësore në vijim: TPNJ, *Prokurori k. Boshkoskit dhe Tarçulovskit*, IT-04-82-T, Aktgjykim, 10 korrik 2008 (“Aktgjykimi Boshkoski dhe Tarçulovski”), paras 607-608 (shih gjithashtu TPNJ, *Prokurori k. Boshkoskit dhe Tarçulovskit*, IT-04-82-A, Judgment, 19 May 2010); ICTY, *Prosecutor v. Zelenović*, IT-96-23/2-S, Sentencing Judgment, 4 April 2007 (“Zelenović Judgment”), paras 70-71 (see also ICTY, *Prosecutor v. Zelenović*, IT-96-23/2-A, Judgment on Sentencing Appeal, 31 October 2007); ICTY, *Prosecutor v. Rajić*, IT-95-12-S, Sentencing Judgment, 8 May 2006 (“Rajić Judgment”), paras 13-18, 49, 96, 184; TPNJ, *Prokurori kundër Limajt dhe të tjerëve*, IT-03-66-T, Aktgjykim, 30 nëntor 2005 (“Aktgjykimi Limaj dhe të tjerët”), para. 741-742 (shih gjithashtu TPNJ, *Prokurori kundër Limajt dhe të tjerëve*, IT-03-66-A, Aktgjykim, 27 shtator 2007); ICTY, *Prosecutor v. Vasiljević*, IT-98-32-A, Judgment, 25 February 2004 (“Vasiljević Appeal Judgment”), paras 147, 182 (see also ICTY, *Prosecutor v. Vasiljević*, IT-98-32-T, Judgment, 29 November 2002); ICTY, *Prosecutor v. Mucić et al.*, IT-96-21-Abis, Judgment on Sentence Appeal, 8 April 2003 (“Mucić et al. Judgment on Sentence Appeal”), paras 1, 5, 61 (shih gjithashtu ICTY, *Prosecutor v. Mucić et al.*, IT-96-21-Tbis-R117, Sentencing Judgment, 9 October 2001 (“Mucić et al. Sentencing Judgment”)); ICTY, *Prosecutor v. Delalić et al.*, IT-96-21-A, Judgment, 20 February 2001 (“Delalić et al. Appeal Judgment”); ICTY, *Prosecutor v. Delalić et al.*, IT-96-21-T, Judgment, 16 November 1998 (“Delalić et al. Trial Judgment”). Paneli i Apelit vëren se ndonëse ndërmjet këtyre çështjeve gjyqësore dhe asaj të Mustafës ka ngjashmëri, ato mund t’i dallojmë nga çështja gjyqësore e Mustafës, ndër të tjera, për shkak të: (i) ekzistencës së marrëveshjes për pranimin e fajësisë (shih *Rajić Judgment*; *Zelenović Judgment*); (ii) mungesës së pozitës me pushtet të personit të shpallur fajtor (shih p.sh. Aktgjykimin *Limaj dhe të tjerët* (në lidhje me Haradin Balën)); (iii) përgjegjesisë penale dytësore, të plotë ose të pjesshme (shih p.sh. *Vasiljević Judgment*; Aktgjykimi *Boshkoski dhe Tarçulovski* (në lidhje me Johan Tarçulovskin)); dhe (iv) numrit krahasimisht më të madh të viktimave (shih p.sh. *Rajić Judgment*; Aktgjykimi *Boshkoski dhe Tarçulovski* (në lidhje me Johan Tarçulovskin)).

<sup>53</sup> Shih Aktgjykimin e Apelit, para. 478; Vendimin e Gjykatës Supreme, para. 111(iii).

detyruara t'u përmbahen të njëjtave korniza ligjore në lidhje me përcaktimin e dënimeve.<sup>54</sup>

21. Paneli i Apelit thekson se jurisprudenca e analizuar nuk përfshin çështje gjyqësore plotësisht analoge për shkak të numrit të ndryshoreve që kanë të bëjnë me përcaktimin e dënimit, dhe rikujton se përgjegjësia parësore e tij është t'ia përshtatë dënimin rrethanave konkrete të çështjes së Mustafës.<sup>55</sup> Sidoqoftë, me kushtin e mësipërm, Paneli i Apelit pajtohet me argumentin e Panelit të Gjykatës Supreme se në çështjet gjyqësore të analizuara janë dhënë dënime konsiderueshëm më të ulëta se 22 vjet burgim.<sup>56</sup>

22. Paneli i Apelit ka marrë veçanërisht parasysh ngjashmëritë ndërmjet çështjes gjyqësore Mustafa dhe çështjeve gjyqësore *Limaj dhe të tjerët*. dhe *Muçiq dhe të tjerët* në TPNJ, dhe vëren se këto çështje, ndër të tjera, kanë të bëjnë me: (i) persona që janë shpallur fajtorë si kryes kryesorë të (ii) krimeve të luftës, përfshirë vrasjen e paligjshme (ose vrasjen e qëllimshme) dhe torturën, (iii) që janë kryer në kontekstin e një qendre ndalimi, (iv) kundër një numri të ngjashëm viktimash të krimeve të

---

<sup>54</sup> Paneli i Gjykatës Supreme konstatoi se: "Dhomat e Specializuara janë të detyruara të marrin në konsideratë se cili prej shkallëzimeve përkatëse të dënimit sipas legjislacionit të Kosovës është më i butë, në përputhje me parimin *lex mitior*. Më pas, paneli që shqipton dënimin duhet ta marrë parasysh shkallëzimin në fjalë kur përcakton dënimin me burgim." Shih Vendimin e Gjykatës Supreme, para. 87. Krahasojë me ICTY, *Prosecutor v. Dragan Nikolić*, IT-94-2-A, Judgement on Sentencing Appeal, 4 February 2005, paras 80-85.

<sup>55</sup> ICTY, *Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-A, Judgement, 30 January 2015, para. 1998; TPNJ, *Prokurori k. Shainoviqit.*, IT-05-87-A, Aktgjykim, 23 janar 2014, para. 1837; Aktgjykimi i Apelit *Gucati dhe Haradinaj*, para. 435. Gjithashtu, Paneli i Apelit rikujton se një vendim i mëhershëm dënimi mund të jetë orientues, nëse ka të bëjë me një njëjtën vepër penale dhe është kryer në rrethana në thelb të ngjashme; sidoqoftë, roli orientues është i kufizuar dhe zbatimi analog i dënimeve nga një çështje gjyqësore në tjetrën, është i pamundur, duke pasur parasysh detyrimin parësor për individualizimin e dënimit, në mënyrë që ai të pasqyrojë në mënyrën e duhur faktet konkrete të çështjes dhe rrethanat personale të personit të shpallur fajtor. Shih Aktgjykimin e Apelit, para. 478; Aktgjykimi i Apelit *Gucati dhe Haradinaj*, para. 434; ICTY, *Prosecutor v. Strugar*, IT-01-42-A, Judgement, 17 July 2008, para. 348; ICTY, *Prosecutor v. Momir Nikolić*, IT-02-60/1-A, Judgement on Sentencing Appeal, 8 March 2006, para. 38; ICTY, *Prosecutor v. Furundžija*, IT-95-17/1-A, Judgement, 21 July 2000, para. 250.

<sup>56</sup> Shih Vendimin e Gjykatës Supreme, para. 105.

përmendura më lart.<sup>57</sup> Paneli gjithashtu thekson se Bala, Lanxho dhe Deliqi u dënuan përkatësisht me 13, 15 dhe 18 vjet burgim.<sup>58</sup>

23. Paneli i Apelit në vijim do të përcaktojë dënimin e Mustafës.

24. Paneli i Apelit mbetet i mendimit se Trupi Gjykes tejkaloj kufijtë e diskrecionit të vet, duke i dhënë z. Mustafa dënime jashtë proporcionit të arsyeshëm krahasuar me një varg dënimesh të dhëna në rrethana të ngjashme për vepra penale të ngjashme.<sup>59</sup> Këtë përfundim Paneli i Apelit e ka arritur pas udhëzimeve të dhëna nga Paneli i Gjykatës Supreme dhe duke pasur parasysh rregullën 163 të Rregullores,<sup>60</sup> shkallëzimin më të butë të dënimit që duhet të merret parasysh në përputhje me parimin kushtetues të *lex mitior* dhe nenin 44(2)(b) të Ligjit (sipas të cilit, dënimi më i lartë që mund të jepet është me 25 vjet burgim),<sup>61</sup> rrethanat konkrete të çështjes së Mustafës,<sup>62</sup> dhe vargun e dënimeve të dhëna në çështjet që ka analizuar.<sup>63</sup> Paneli i Apelit gjykon se ky disproporcionalitet përlligj një ulje të konsiderueshme të dënimit të dhënë për veprën penale sipas Pikës 3 (torturë si krim lufte, kryer kundër së paku gjashtë personave) dhe për veprën penale sipas Pikës 4 (vrasje e paligjshme si krim lufte, kryer kundër një personi). Në lidhje me ndalimin arbitrar, Paneli i Apelit vëren se dënimi me tetë vjet burgim që Paneli i Apelit dha për këtë vepër penale sipas Pikës 1 (ndalim arbitrar si krim lufte, kryer kundër së paku gjashtë personave), është në

<sup>57</sup> Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerët*, para. 741-742; *Mucić et al.* Judgment on Sentence Appeal, paras 1, 5, 61. Sidoqoftë, Paneli i Apelit vëren gjithashtu këto dallime të dukshme: (i) ndryshe nga Mustafa, as Bala, as Lanxho nuk ishin në pozitë komanduese; (ii) në çështjen gjyqësore *Muçiqi dhe të tjerët*, një numër i konsiderueshëm të burgosurish u mbajtën të ndaluar në kampin e burgimit në Çelebiqi gjatë periudhës së akuzave; dhe (iii) ndryshe nga Mustafa, u konstatua se Lanxho dhe Deliqi ishin individë "sadistë". Shih *Delalić et al.* Trial Judgement, paras 146-157, 1130, 1261-1269, 1272-1275. Shih gjithashtu *Delalić et al.* Appeal Judgement, paras 825, 834; *Mucić et al.* Sentencing Judgement, paras 29-30, 37-38; *Mucić et al.* Judgment on Sentence Appeal, para. 40.

<sup>58</sup> Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerët*, para. 742; *Mucić et al.* Judgment on Sentence Appeal, paras 1, 61.

<sup>59</sup> Shih Aktgjykimin e Apelit, para. 479. Shih gjithashtu poshtëshënimin 32 më lart.

<sup>60</sup> Vendimi i Gjykatës Supreme, para. 111(i).

<sup>61</sup> Shih më lart, para. 11-12, 15, 18. Shih gjithashtu Vendimin e Gjykatës Supreme, para. 102, 107, 111(ii).

<sup>62</sup> Shih më lart, para. 15, 19. Shih gjithashtu Vendimin e Gjykatës Supreme, para. 111(v).

<sup>63</sup> Shih më lart, para. 15, 20-22. Shih gjithashtu Vendimin e Gjykatës Supreme, para. 111(iii) and (iv).

kufirin e poshtëm të shkallëzimit të dënimit<sup>64</sup> dhe e gjykon të përshtatshme ta lërë siç është dënimin për këtë vepër penale.

25. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit shqipton dënimet në vijim:

- (i) tetë vjet burgim për krimin e luftës të ndalimit arbitrar (Pika 1);
- (ii) 13 vjet burgim për krimin e luftës të torturës (Pika 3); dhe
- (iii) 15 vjet burgim për krimin e luftës të vrasjes së paligjshme (Pika 4).

26. Pasi ka përcaktuar këto dënime për secilën vepër penale, Paneli i Apelit në vijim konstaton se dënimi i njësuar me 22 vjet burgim i dhënë nga Paneli i Apelit, është jashtë proporcionit të arsyeshëm, duke pasur parasysh shkallëzimin e konstatuar të dënimit, jurisprudencën e analizuar dhe rrethanat konkrete të çështjes së Mustafës. Rrjedhimisht, Paneli gjykon se një dënim i njësuar me 15 vjet burgim, në të cilin llogaritet koha e kaluar në paraburgim që nga arrestimi i tij më 24 shtator 2020, pasqyron tërësinë e veprimtarisë kriminale të Mustafës në këtë çështje gjyqësore.

27. Së fundi, Paneli i Apelit rithekson se krimet për të cilat Mustafa u shpall fajtor dhe u dënua janë të rënda dhe se ky vendim i ri dënim i nuk e ndryshon peshën e këtyre krimeve.<sup>65</sup>

### III. VENDIM

28. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit, në bazë të Vendimit të Gjykatës Supreme dhe rregullës 194(1)(b) të Rregullores:

**SHQIPTON** dënimin me tetë vjet burgim në lidhje me Pikën 1;

**SHQIPTON** dënimin me 13 vjet burgim në lidhje me Pikën 3;

---

<sup>64</sup> Paneli i Apelit rikujton se në lidhje me Pikën 1, e uli nga 10 në 8 vjet burgim dënimin e dhënë nga Trupi Gjyqësor. Shih Aktgjykimin e Apelit, para. 480, 484.

<sup>65</sup> Shih Aktgjykimin e Apelit, para. 482.

**SHQIPTON** dënimin me 15 vjet burgim në lidhje me Pikën 4; dhe

**SHQIPTON** dënimin e njësuar me 15 vjet burgim për Mustafën, në të cilin llogaritet koha e kaluar në paraburgim;

**VENDOS** që ky Aktgjykim të zbatohet me efekt të menjëhershëm në bazë të rregullës 185(1) të Rregullores; dhe

**URDHËRON** që, në pajtim me nenin 50(1) të Ligjit dhe rregullën 166(3) të Rregullores, Mustafa të mbetet në paraburgim të Dhomave të Specializuara deri në finalizimin e masave për transferimin e tij në shtetin ku do të vuajë dënimin.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Mishelë Pikar,  
Kryegjykatëse**

E martë, 10 shtator 2024

Në Hagë, Holandë.